



UNIVERSITETI METROPOLITAN TIRANA

RAPORT I VLERËSIMIT TË PËRVOJËS SË STUDENTËVE TË VITIT TË PARË

VITI AKADEMIK 2025–2026

Institucioni	: Universiteti Metropolitan Tirana
Njësia përgjegjëse	: Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC)
Periudha kohore	: 17 – 23 nëntor 2025
Metoda e plotësimit	: Online – Edu4School
Numri i pjesëmarrësve	: 248 studentë të vitit të parë
Përgatiti	: Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë
Data e publikimit	: 30 janar, 2026

Tabela e përmbajtjes

Tabela e përmbajtjes.....	2
Lista e tabelave.....	3
Hyrje.....	4
Përbërja e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.....	4
Metodologjia.....	5
TË DHËNA TË PËRGJITHSHME.....	6
I. PRITSHMËRITË DHE EKSPERIENCAT E PARA.....	8
Mënyrat e informimit për UMT përpara regjistrimit.....	8
Faktorët ndikues në zgjedhjen e programit të studimeve në UMT.....	9
Përputhja e pritshmërive para regjistrimit me përvojën aktuale të studentëve në UMT.....	11
Përmbledhje mbi pritshmëritë dhe eksperiencat e para të studentëve.....	12
II. VLERËSIMI I INFRASTRUKTURËS DHE SHËRBIMEVE.....	14
Procesi i orientimit për studentët e rinj.....	14
Procesi i regjistrimit në UMT.....	15
Platforma online (Edu4School).....	15
Informimi mbi të drejtat dhe detyrimet e studentëve.....	16
Qartësia dhe zbatueshmëria e rregulloreve dhe politikave të universitetit.....	17
Udhëzimi për përdorimin e platformave teknologjike.....	18
Infrastruktura teknologjike e UMT.....	19
Orari i leksioneve dhe seminareve.....	19
Pastërtia dhe mirëmbajtja e ambienteve të UMT.....	20
Cilësia e mësimdhënies në UMT.....	21
Përmbledhje e rezultateve mbi përvojat funksionale dhe operacionale të studentëve.....	22
SHËRBIMET AKADEMIKE DHE ADMINISTRATIVE.....	23
Sekretaria mësimore.....	23
Koordinatori i fakultetit.....	24
Këshillimi akademik (përgjegjësit e programeve / këshilltarët akademikë).....	25
Procesi i regjistrimit të lëndëve.....	25
Përmbledhje mbi vlerësimin e shërbimeve akademike dhe administrative.....	26
NJOHJA ME MUNDËSITË JASHTË KURRIKULËS.....	27
Njohja me klubet studentore dhe aktivitetet jashtë mësimore.....	27
Aktivitetet e organizuara nga dekanati i studentëve.....	28
Informimi mbi mundësitë e këshillimit për karrierë.....	29
Mjedisi social dhe përfshirja në jetën jashtë mësimore.....	29
Përmbledhje e vlerësimit mbi njohjen dhe përfshirjen në mundësitë jashtë kurrikulës.....	30
PËRMBLEDHJE SINTETIKE E PËRGJIGJEVE NË PYETJEN E HAPUR.....	31
PËRFUNDIME.....	32
Pikat më të forta të institucionit (sipas fushave të vlerësimit).....	32
Rekomandime (jo-obliguese).....	33
ANEKS I: Paraqitja grafike e rezultateve (Bar Charts).....	33
ANEKS I: Formulari i pyetësorit për vlerësimin e përvojës së studentëve të vitit të parë në UMT.....	46

Lista e tabelave

Tabela 1 Shpërndarja gjinore e studentëve pjesëmarrës në pyetësor.....	6
Tabela 2 Shpërndarja e studentëve pjesëmarrës sipas programeve të studimit..	6
Tabela 3 Shpërndarja e studentëve pjesëmarrës sipas qytetit të origjinës....	7
Tabela 4 Mënyrat e informimit për UMT përpara regjistrimit.....	8
Tabela 5 Faktorët ndikues në zgjedhjen e programit të studimeve në UMT.....	9
Tabela 6 Përputhja midis informacionit të ofruar dhe përvojës reale të studentëve në UMT.....	11
Tabela 7 Përputhja e pritshmërive para regjistrimit me përvojën aktuale të studentëve në UMT.....	11
Tabela 8 Procesi i orientimit për studentët e rinj.....	14
Tabela 9 Procesi i regjistrimit në UMT.....	15
Tabela 10 Platforma online (Edu4School).....	16
Tabela 11 Informimi mbi të drejtat dhe detyrimet e studentëve.....	17
Tabela 12 Qartësia dhe zbatueshmëria e rregulloreve dhe politikave të universitetit.....	17
Tabela 13 Udhëzimi për përdorimin e platformave teknologjike.....	18
Tabela 14 Infrastruktura teknologjike e UMT.....	19
Tabela 15 Orari i leksioneve dhe seminareve.....	20
Tabela 16 Pastërtia dhe mirëmbajtja e ambienteve të UMT.....	20
Tabela 17 Cilësia e mësimdhënies në UMT.....	21
Tabela 18 Sekretaria mësimore.....	23
Tabela 19 Koordinator i fakultetit.....	24
Tabela 20 Këshillimi akademik (përgjegjësit e programeve / këshilltarët akademikë).....	25
Tabela 21 Procesi i regjistrimit të lëndëve.....	26
Tabela 22 Njohja me klubet studentore dhe aktivitetet jashtë mësimore.....	27
Tabela 23 Aktivitetet e organizuara nga dekanati i studentëve.....	28
Tabela 24 Informimi mbi mundësitë e këshillimit për karrierë.....	29
Tabela 25 Mjedisi social dhe përfshirja në jetën jashtë mësimore.....	30

Hyrje

Në kuadër të procesit të sigurimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) në Universitetin Metropolitan Tirana (UMT) ka realizuar *pyetësin për vlerësimin e përvojës së studentëve të vitit të parë*, i cili është pjesë integrale e paketës së instrumenteve të sigurimit të cilësisë të institucionit. Ky instrument është hartuar me qëllim mbledhjen e të dhënave të strukturuar mbi pritshmëritë fillestare të studentëve, përvojën e tyre gjatë fazës së parë të studimeve, si dhe perceptimet/vlerësimet mbi proceset akademike, shërbimet administrative dhe infrastrukturën institucionale të UMT.

Pyetësi u administrua gjatë javës së gjashtë të semestrit, në periudhën 17-23 nëntor 2025 një fazë kohore që u vlerësua e përshtatshme për të siguruar vlerësime të informuara dhe të qëndrueshme nga studentët e vitit të parë, pas krijimit të një eksperience fillestare me mjedisin universitar, organizimin akademik dhe shërbimet mbështetëse, si edhe pa u ndikuar nga rezultatet e vlerësimeve në provimet e para. Kjo qasje mundëson një vlerësim më realist të përputhjes ndërmjet informacionit të ofruar para regjistrimit dhe përvojës aktuale studentore.

Të dhënat e mbledhura përmes këtij pyetësi përbëjnë një bazë të rëndësishme për vlerësimin e përvojës së studentëve të vitit të parë dhe për identifikimin e tendencave kryesore që lidhen me integrimin universitar, funksionimin e proceseve institucionale dhe cilësinë e shërbimeve të ofruara. Gjetjet synojnë të mbështesin proceset vendimmarrëse dhe ndërhyrjet për përmirësim, duke kontribuar në forcimin e mekanizmave të sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe në rritjen e cilësisë së përvojës studentore në Universitetin Metropolitan Tirana.

Përbërja e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë

Në kuadër të proceseve të sigurimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë akademike dhe institucionale, **Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC)** pranë UMT për vitin akademik **2025–2026** përbëhet nga anëtarët e mëposhtëm, të cilët përfaqësojnë struktura të ndryshme akademike dhe studentore, duke garantuar një qasje gjithëpërfshirëse dhe të balancuar në vlerësimin e cilësisë:

- | | |
|-----------------------------------|---|
| 1. Ark. Fatlinda Struga | <i>Kryetare</i> |
| 2. Dr. Almarin Frakulli | <i>Anëtar</i> |
| 3. Msc. Virtyt Lesha | <i>Anëtar</i> |
| 4. Prof. Asoc. Dr. Ramadan Çipuri | <i>Ekspert i jashtëm</i> |
| 5. Msc. Albina Joga | <i>Anëtare (Përfaqësuese e administratës)</i> |
| 6. Anja Balliu | <i>Përfaqësuese e studentëve</i> |

Kjo përbërje siguron ndërthurjen e ekspertizës akademike, përvojës profesionale dhe perspektivës studentore në proceset e planifikimit, monitorimit dhe vlerësimit të cilësisë, duke kontribuar në forcimin e mekanizmave të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Metodologjia

Ky vlerësim bazohet në një qasje *sasiore*, të kombinuar me atë *cilësore*, përmes administrimit të një pyetësi të strukturuar, i cili është zhvilluar në një fazë të hershme të ciklit akademik, *para zhvillimit të provimeve të para të studentëve*, me qëllim minimizimin e ndikimit të faktorëve vlerësues apo emocionalë që mund të ndikojnë perceptimet e tyre mbi përvojën universitare. Për këtë arsye, pyetësi është administruar gjatë *javës së gjashtë të semestrit (17-23 nëntor 2025)*, një periudhë që lejon krijimin e një përvoje fillestare të mjaftueshme, pa u ndikuar ende nga rezultatet akademike.

Pyetësi është shpërndarë në mënyrë elektronike përmes platformës *Edu4School*, duke iu dërguar studentëve të *të gjitha programeve të studimit në vitin e parë* në Universitetin Metropolitar Tirana. Plotësimi i pyetësit është realizuar në kushte *të plota anonimiti*, në përputhje me parimet e mbrojtjes së të dhënave dhe etikës së vlerësimit institucional, duke garantuar liri shprehjeje dhe sinqeritet në përgjigje.

Në total, pyetësi është plotësuar nga *248 studentë*, nga një popullatë prej *360 studentësh* të regjistruar në vitin e parë të studimeve. Ky nivel pjesëmarrjeje ofron një bazë të mjaftueshme për nxjerrjen e përfundimeve deskriptive dhe për identifikimin e tendencave kryesore në lidhje me përvojën e studentëve të vitit të parë.

Pjesa sasiore e pyetësit përfshin pohime të strukturuar, të vlerësuara përmes një shkalle Likert me pesë nivele (nga 1 – *plotësisht kundër* deri në 5 – *plotësisht dakord*), duke mundësuar analizë deskriptive dhe krahasuese sipas fushave tematike. Paralelisht, pyetësi përfshin edhe një seksion me *pyetje të hapura*, i cili përbën bazën e qasjes cilësore të këtij vlerësimi. Përgjigjet e hapura shërbejnë për të plotësuar dhe kontekstualizuar të dhënat sasiore, duke reflektuar përvoja individuale, vëzhgime konkrete dhe sugjerime për përmirësim nga perspektiva e studentëve.

Vlerësimi mbështetet në disa fusha tematike kryesore, të cilat pasqyrojnë dimensionet e ndryshme të përvojës studentore, konkretisht:

- Pritshmëritë dhe eksperiencat e para,
- Vlerësimi i infrastrukturës dhe shërbimeve,
 - Shërbimet akademike dhe administrative,
 - Njohja me mundësitë jashtë kurrikulës,
- si dhe komente shpesh, të analizuar përmes një qasjeje cilësore për të identifikuar temat kryesore dhe shqetësimet e përsëritura.

Kombinimi i qasjes sasiore me atë cilësore mundëson një analizë më të thelluar dhe më të balancuar të përvojës së studentëve të vitit të parë, duke ofruar jo vetëm tregues numerikë të vlerësimit, por edhe kuptim interpretues mbi arsyet, pritshmëritë dhe nevojat e tyre.

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME

Në kampionin e përfshirë në vlerësim, studentët meshkuj përbëjnë shumicën, me 62.1% të të anketuarve (154 studentë), ndërsa studentet femra përbëjnë 37.9% (94 studente). Në total, në pyetësor kanë marrë pjesë 248 studentë.

Tabela 1 Shpërndarja gjinore e studentëve pjesëmarrës në pyetësor

Gjinia:					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Femër	94	37.9	37.9	37.9
	Mashkull	154	62.1	62.1	100.0
	Total	248	100.0	100.0	

Tabela 2 paraqet pjesëmarrjen e studentëve në pyetësor, e shprehur në numra absolutë dhe përqindje, sipas programeve të studimit ku ata janë të regjistruar.

Tabela 2 Shpërndarja e studentëve pjesëmarrës sipas programeve të studimit

Programi i studimit					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	BA në "Informatike Ekonomike" (anglisht)	10	4.0	4.0	4.0
	BA në "Informatikë Ekonomike" (shqip)	14	5.6	5.6	9.7
	BA në "Inteligjencë Artificiale";	5	2.0	2.0	11.7
	BA në "Inxhinieri Kompjuterike";	41	16.5	16.5	28.2
	BA në "Inxhinieri Ndërtimi";	27	10.9	10.9	39.1
	BA në "Inxhinieri Software" (anglisht);	27	10.9	10.9	50.0
	BA në Administrim Biznesi me profile: "Menaxhim", "Marketing", "Sipërmarrje dhe Inovacion";	21	8.5	8.5	58.5
	BA në Financë me dy profile: "Kontabilitet", "FinTech";	16	6.5	6.5	64.9
	BA në Inxhinieri Elektrike me profile: "Sistemet e fuqisë", "Elektronikë", "Komunikime dixhitale", "Kontroll inxhinierik", "Makinieri elektrike";	33	13.3	13.3	78.2
	Program i Integruar i Nivelit të Dytë në Arkitekturë	17	6.9	6.9	85.1
	Program Profesional në "Dizajn dhe Zhvillim Software";	13	5.2	5.2	90.3
	Program Profesional në "Grafik Dizajn"	3	1.2	1.2	91.5
	Program profesional në "Menaxhim në Turizëm,	21	8.5	8.5	100.0

	Hoteleri dhe Evente”;				
	Total	248	100.0	100.0	

Të dhënat (Tabela 3) tregojnë se shumica e studentëve pjesëmarrës vijnë nga Tirana, e cila përfaqëson 41.9% të kampionit (104 studentë), çka është e pritshme duke qenë qyteti më i madh dhe qendra kryesore urbane e vendit. Pas Tiranës, përfaqësim më të lartë kanë Elbasani me 14.1% (35 studentë), si dhe Librazhdi dhe Lushnja, secili me 4.0% (10 studentë). Qytetet e tjera paraqiten me përqindje më të ulëta dhe shpërndarje më të fragmentuar, duke reflektuar një origjinë gjeografike të larmishme të studentëve të përfshirë në pyetësor.

Tabela 3 Shpërndarja e studentëve pjesëmarrës sipas qytetit të origjinës

Qyteti nga vini:					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Belsh	1	.4	.4	.4
	Berat	5	2.0	2.0	2.4
	Bilisht	1	.4	.4	2.8
	Bulqiza	1	.4	.4	3.2
	Burrel	4	1.6	1.6	4.8
	Cërrik	2	.8	.8	5.6
	Corovode	1	.4	.4	6.0
	Divjake	1	.4	.4	6.5
	Durrës	1	.4	.4	6.9
	Elbasan	35	14.1	14.1	21.0
	Fier	8	3.2	3.2	24.2
	Fushe Kruje	1	.4	.4	24.6
	Gjirokaster	4	1.6	1.6	26.2
	Gramsh	4	1.6	1.6	27.8
	Himare	1	.4	.4	28.2
	Kavaje	1	.4	.4	28.6
	Korce	9	3.6	3.6	32.3
	Kruje	1	.4	.4	32.7
	Kucove	2	.8	.8	33.5
	Kukës	5	2.0	2.0	35.5
	Laç	1	.4	.4	35.9
	Lezhe	3	1.2	1.2	37.1
	Librazhd	10	4.0	4.0	41.1
	Lushnje	10	4.0	4.0	45.2
	Mallakaster	1	.4	.4	45.6
	Peqin	1	.4	.4	46.0
	Perrenjas	2	.8	.8	46.8
	Peshkopi	4	1.6	1.6	48.4
	Pogradec	2	.8	.8	49.2
	Sarandë	3	1.2	1.2	50.4
	Shkoder	5	2.0	2.0	52.4
	Tepelena	2	.8	.8	53.2
	Thumane	1	.4	.4	53.6
	Tiranë	104	41.9	41.9	95.6
	Tropoje	3	1.2	1.2	96.8
	Vau Dejës	1	.4	.4	97.2
	Vlorë	7	2.8	2.8	100.0
	Total	248	100.0	100.0	

I. PRITSHMËRITË DHE EKSPERIENCAT E PARA

Të dhënat e kësaj fushe ofrojnë një pasqyrë të rëndësishme mbi mënyrën se si formohen pritshmëritë fillestare dhe perceptimet e para ndaj institucionit, përpara dhe gjatë kontaktit të parë me UMT. Për këtë arsye, rezultatet nuk kanë vlerë vetëm për hierarkinë institucionale dhe menaxhmentin akademik, por *duhen lexuar me vëmendje të shtuar edhe nga strukturat që lidhen drejtpërdrejt me komunikimin, promovimin dhe proceset e pranimit*, pasi ato pasqyrojnë efektivitetin e kanaleve informuese, besimin e ndërtuar në publik dhe përputhjen midis imazhit të komunikuar dhe përvojës së perceptuar nga studentët potencialë.

Mënyrat e informimit për UMT përpara regjistrimit

Të dhënat (Tabela 4) tregojnë qartë se informimi për UMT mbështetet në mënyrë dominuese te kanalet e besimit social, veçanërisht prindërit ose të afërmit (22.6%) dhe studentët aktualë të UMT (22.2%), të ndjekur nga shokët/shoqet (14.9%). Kjo strukturë e burimeve të informimit përbën një tregues të fortë se *reputacioni institucional dhe përvoja reale e studentëve funksionojnë si mekanizma kryesorë marketingu*, duke ndikuar drejtpërdrejt në formimin e pritshmërive dhe në vendimmarrjen fillestare për regjistrim. Në këtë kuptim, të dhënat evidentojnë se *marketingu i bazuar në përvojë dhe rekomandim (word-of-mouth)* përfaqëson një nga pikat më të forta të komunikimit të UMT.

Ndërkohë, kanalet formale të promovimit institucional, si *panaiet dhe prezantimet e organizuara nga UMT* (6.5%), *kontakti me pedagogët* (3.2%) dhe *informimi përmes mësuesve të shkollës së mesme* (2.8%), shfaqin një ndikim më të kufizuar, duke sugjeruar hapësira konkrete për përmirësim dhe riorientim strategjik.

Tabela 4 Mënyrat e informimit për UMT përpara regjistrimit

Si keni dëgjuar për UMT? (Mund të zgjidhni më shumë se një alternativë):					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Nga mediat (TV, website, Instagram, Facebook, etj.)	34	13.7	13.7	13.7
	Nga mësuesit e shkollës së mesme	7	2.8	2.8	16.5
	Nga panaiet ose prezantime të organizuara nga UMT	16	6.5	6.5	23.0
	Nga pedagogët e UMT	8	3.2	3.2	26.2
	Nga prindërit ose të afërmit	56	22.6	22.6	48.8
	Nga shokët/shoqet	37	14.9	14.9	63.7
	Nga studentët aktualë të UMT	55	22.2	22.2	85.9
	Tjetër	35	14.1	14.1	100.0
Total		248	100.0	100.0	

Ky rezultat përbën një nga pikat më të forta të marketingut institucional të UMT, i cili mund dhe duhet të vijojë të zhvillohet më tej përmes *fuqizimit të rolit të studentëve aktualë si ambasadorë të institucionit dhe përfshirjes së prindërve në komunikimin publik*. Paralelisht, rekomandohet

t'i kushtohet vëmendje e shtuar kanaleve me ndikim më të ulët, përmes ristrukturimit të pjesëmarrjes në panairë, krijimit të programeve të orientimit për mësuesit e shkollave të mesme dhe shtimit të prezencës së pedagogëve në aktivitetet informuese, me synim balancimin dhe zgjerimin e bazës së informimit për UMT.

Përtej konsolidimit dhe përmirësimit të kanaleve ekzistuese të promovimit, dhe duke respektuar angazhimin dhe përvojën profesionale të strukturave dhe personelit të dedikuar në këto fusha, NJSBC paraqet disa orientime shtesë, të cilat mund të konsiderohen në vijimësi, në funksion të prioriteteve institucionale dhe vlerësimit profesional të vetë strukturave përgjegjëse. Këto orientime përfshijnë:

- a) organizimi i ditëve tematike të hapura në kampus (open days me fokus programor),*
- b) aktivitete orientuese të tipit “student për një ditë”,*
- c) sesione informuese të kombinuara me mini-workshope akademike,*
- d) përfshirja më aktive e alumni-ve në prezantimin e rrugëtimit të tyre profesional.*

Këto forma kontribuojnë në ndërtimin e një kontakti më të drejtpërdrejtë dhe më realist me institucionin, duke forcuar pritshmëritë e studentëve potencialë dhe duke diferencuar qasjen promovuese të UMT nga komunikimi standard institucional.

Faktorët ndikues në zgjedhjen e programit të studimeve në UMT

Të dhënat tregojnë se zgjedhja e programit të studimeve në UMT ndikohet kryesisht nga *elementë akademikë dhe reputacionalë*, ku spikat qartë *emërtimi dhe cilësia akademike e programit* (24.2%), si faktori më i rëndësishëm në vendimmarrjen e studentëve. Kjo pasohet nga *kategoria “Tjetër”* (16.9%), e cila sugjeron motive individuale ose specifike për programin, si dhe nga *rekomandimet e prindërve ose të afërmeve* (14.1%) dhe *reputacioni pozitiv i UMT në tregun akademik* (12.9%).

Një rol domethënës, por dytësor, luajnë *rekomandimet nga miqtë ose ish-studentët* (8.5%) dhe *eksperienca dhe përkushtimi i pedagogëve* (8.1%), ndërsa faktorë më pragmatikë, si *afërsia gjeografike* (6.9%) dhe *tarifat konkurruese* (4.0%), rezultojnë më pak përcaktues në zgjedhjen finale. *Fushatat promovuese në media* (4.4%) shfaqin një ndikim relativisht të kufizuar, duke sugjeruar se vendimmarrja e studentëve bazohet më shumë në përmbajtjen akademike dhe reputacionin sesa në komunikimin formal promovues.

Tabela 5 Faktorët ndikues në zgjedhjen e programit të studimeve në UMT

Cili/cilët faktorë ndikuan në zgjedhjen e programit tuaj të studimeve në UMT? (Mund të zgjidhni më shumë se një alternativë)				
	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent

Valid	Afërsia e universitetit me vendin e banimit tim	17	6.9	6.9	6.9
	Eksperiencia dhe përkushtimi i pedagogëve të UMT	20	8.1	8.1	14.9
	Emërtimi dhe cilësia akademike e programit të studimeve	60	24.2	24.2	39.1
	Fushatat promovuese të UMT në media (TV, internet, rrjete sociale, etj.)	11	4.4	4.4	43.5
	Rekomandimet nga miqtë ose ish-studentët e UMT	21	8.5	8.5	52.0
	Rekomandimet nga prindërit ose të afërmit	35	14.1	14.1	66.1
	Reputacioni pozitiv i UMT në tregun akademik	32	12.9	12.9	79.0
	Tarifat konkurruese të studimeve	10	4.0	4.0	83.1
	Tjetër	42	16.9	16.9	100.0
	Total	248	100.0	100.0	

Ky konfigurim i faktorëve përbën një tregues pozitiv për pozicionimin akademik të UMT, pasi zgjedhja e programit mbështetet kryesisht në cilësinë e ofertës dhe perceptimin e qëndrueshëm të institucionit.

*Përtej ruajtjes së këtyre avantazheve, NJSBC sugjeron që të eksplorohehen edhe forma plotësuese promovimi të orientuara drejt thellimit të përmbajtjes akademike, **në masën dhe formën që vlerësohet e përshtatshme nga strukturat përgjegjëse për komunikimin, promovimin dhe zhvillimin e programeve**, duke respektuar plotësisht autonominë e tyre profesionale dhe vlerësimin kontekstual të nevojave institucionale. Në mënyrë që faktorët akademikë që tashmë ndikojnë pozitivisht të bëhen edhe më të dukshëm për studentët potencialë, sugjerojmë edhe*

- prezantime tematike të programeve,*
- sesione orientuese mbi kompetencat dhe rezultatet e të nxënit,*
- komunikim më i strukturuar mbi perspektivat profesionale të secilit program.*

Përputhja midis informacionit të ofruar dhe përvojës reale të studentëve në UMT

Të dhënat (Tabela 6) tregojnë një *vlerësim qartësisht pozitiv* lidhur me përputhjen midis informacionit të ofruar nga UMT dhe përvojës reale të studentëve. Në total, *71.8% e respondentëve (vlerësimet 4 dhe 5)* shprehen dakord ose plotësisht dakord me pohimin, duke dëshmuar se pritshmëritë e krijuara përmes mediave dhe stafit të institucionit janë, në pjesën dërrmuese të rasteve, në harmoni me realitetin akademik dhe institucional të përjetuar nga studentët.

Një *përqindje 22.2%* pozicionohet në qëndrim neutral, çka sugjeron se për një pjesë të studentëve përvoja ka qenë as përforcuese, as zhgënjyese në raport me informacionin fillestar. Ndërkohë, *vetëm 6.0%* shprehen në mosdakordësi (vlerësimet 1 dhe 2), një tregues i ulët që nuk cenon leximin

e përgjithshëm pozitiv të këtij rezultati.

Tabela 6 Përputhja midis informacionit të ofruar dhe përvojës reale të studentëve në UMT

Informacioni i ofruar nga UMT, përmes mediave dhe stafit të institucionit, përputhet me pritshmëritë e mia dhe përvojën reale që kam pasur si student në këtë universitet.					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1 - Aspak dakord	8	3.2	3.2	3.2
	2 - S'jam dakord	7	2.8	2.8	6.0
	3 - Neutral	55	22.2	22.2	28.2
	4 - Dakord	110	44.4	44.4	72.6
	5 - Plotësisht dakord	68	27.4	27.4	100.0
	Total	248	100.0	100.0	

Në tërësi, këto të dhëna sinjalizojnë një *koherencë të qëndrueshme midis komunikimit institucional dhe përvojës reale*, element kyç për ndërtimin e besimit dhe pritshmërive realiste të studentëve.

Përputhja e pritshmërive para regjistrimit me përvojën aktuale të studentëve në UMT

Të dhënat pasqyrojnë një *përputhje të lartë dhe të qëndrueshme midis pritshmërive të studentëve para regjistrimit dhe përvojës së tyre aktuale në UMT*. Konkretisht, 74.2% e tyre shprehen dakord ose plotësisht dakord (vlerësimet 4 dhe 5) me pohimin, duke treguar se për shumicën dërrmuese të studentëve pritshmëritë fillestare janë realizuar në praktikë.

Një *përqindje 20.6%* pozicionohet në qëndrim neutral, çka sugjeron se për një pjesë të studentëve përvoja aktuale as nuk ka tejkaluar dhe as nuk ka zhgënjyer pritshmëritë fillestare. Ndërkohë, 5.2% e studentëve shprehen në mosdakordësi (vlerësimet 1 dhe 2), një nivel i ulët që nuk ndryshon vlerësimin përgjithësisht pozitiv të këtij treguesi.

Rezultati konfirmon një *koherencë funksionale midis pritshmërive të krijuara dhe realitetit akademik të përjetuar*, element thelbësor për besimin institucional dhe qëndrueshmërinë e marrëdhënies student–institucion.

Tabela 7 Përputhja e pritshmërive para regjistrimit me përvojën aktuale të studentëve në UMT

Pritshmëritë e mia para regjistrimit përputhen me përvojën aktuale si student në UMT.
--

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1 - Aspak dakord	7	2.8	2.8	2.8
	2 - S'jam dakord	6	2.4	2.4	5.2
	3 - Neutral	51	20.6	20.6	25.8
	4 - Dakord	121	48.8	48.8	74.6
	5 - Plotësisht dakord	63	25.4	25.4	100.0
	Total	248	100.0	100.0	

Ky vlerësim pozitiv sugjeron se UMT ka arritur të ndërtojë pritshmëri realiste dhe të besueshme përpara regjistrimit. Rekomandohet vijimi i kësaj qasjeje, duke ruajtur përputhjen midis komunikimit paraprak dhe përmbajtjes reale të përvojës akademike, si dhe duke monitoruar në mënyrë periodike grupin neutral për të identifikuar mundësi të mëtejshme për përmirësim cilësor. Ky monitorim mund të mbështetet në analizën e të dhënave të mbledhura nga instrumentet e Paketës së Cilësisë, përfshirë vlerësimin e performancës së pedagogëve, vlerësimin e lëndëve dhe instrumentet institucionale që zhvillohen në mënyrë periodike, duke mundësuar një lexim të vazhdueshëm dhe të integruar të situatës në vijimësi.

Përmbledhje mbi pritshmëritë dhe eksperiencat e para të studentëve

Në tërësi, të dhënat e kësaj fushe pasqyrojnë një *situatë përgjithësisht pozitive* lidhur me formimin e pritshmërive përpara regjistrimit dhe përputhjen e tyre me përvojën reale të studentëve në UMT. Informimi paraprak mbështetet kryesisht në *kanale besimi social dhe reputacion akademik*, ndërsa vlerësimet mbi koherencën midis komunikimit institucional dhe realitetit akademik rezultojnë të larta, duke konfirmuar ndërtimin e pritshmërive realiste dhe të besueshme. Këto rezultate përbëjnë një bazë solide mbi të cilën mund të vijoje zhvillimi i mëtejshëm i praktikave ekzistuese.

Duke respektuar autonominë profesionale të strukturave përgjegjëse dhe në funksion këshillues, NJSBC sugjeron që, *nëse vlerësohen të arsyeshme nga këto struktura*, të merren në konsideratë këto orientime:

- Vijimi dhe formalizimi i rolit të studentëve aktualë dhe alumni-ve** si bartës të përvojës reale akademike, duke e përdorur këtë potencial si një nga pikat më të forta të komunikimit institucional.
- Rritja e dukshmërisë së përmbajtjes akademike të programeve**, përmes prezantimeve tematike, sesioneve orientuese dhe komunikimit më të strukturuar mbi kompetencat dhe rezultatet e të nxënit.
- Pasurimi i disa aktiviteteve promovuese formale**, si panairët dhe prezantimet, me elementë më ndërveprues dhe të lidhur drejtpërdrejt me përvojën akademike, në rastet kur kjo vlerësohet e nevojshme nga strukturat përgjegjëse.
- Monitorimi i vazhdueshëm i grupit neutral**, duke u mbështetur në analizën e të dhënave të mbledhura nga instrumentet e Paketës së Cilësisë, me synim identifikimin e hershëm të hapësirave për përmirësim cilësor.

Këto orientime synojnë të mbështesin dhe të pasurojnë praktikat ekzistuese, pa karakter detyrues, duke ofruar një kornizë reflektimi për zhvillim të mëtejshëm, në përputhje me prioritetet dhe vlerësimet profesionale të vetë strukturave përgjegjëse.

II. VLERËSIMI I INFRASTRUKTURËS DHE SHËRBIMEVE

Kjo pjesë e raportit fokusohet në përvojën konkrete të studentëve në raport me *infrastrukturën dhe shërbimet mbështetëse* të universitetit gjatë vijimit të studimeve, duke përfshirë proceset administrative, përdorimin e platformave teknologjike, organizimin e mësimdhënies dhe jetën studentore. Ndryshe nga pjesa e mëparshme, ku theksi vihej te formimi i pritshmërive dhe përputhja e tyre me përvojën reale, kjo fushë ofron një lexim më operacional të funksionimit të shërbimeve, i cili ka rëndësi të drejtpërdrejtë për strukturat që i ofrojnë këto shërbime dhe për përmirësimin e cilësisë në vijimësi.

Procesi i orientimit për studentët e rinj

Procesi i orientimit për studentët e rinj vlerësohet në mënyrë *kryesisht pozitive*, duke reflektuar një përvojë fillestare funksionale dhe ndihmëse për shumicën e studentëve. *71.0% e respondentëve* shprehen dakord ose plotësisht dakord (vlerësimet 4 dhe 5), çka tregon se orientimi ka kontribuar realisht në kuptimin e strukturës dhe funksionimit të universitetit. Ky rezultat sugjeron se mekanizmat e përdorur gjatë fazës së orientimit arrijnë, në pjesën më të madhe të rasteve, të përmbushin qëllimin e tyre informues dhe integruar (Tabela 8).

Një pjesë 22.6% e studentëve mbeten në qëndrim neutral, duke sinjalizuar se për ta orientimi ka qenë i dobishëm, por jo domosdoshmërisht gjithëpërfshirës ose i personalizuar sipas nevojave individuale. Në të njëjtën kohë, *6.4% e studentëve* shprehen në mosdakordësi, një tregues i ulët që nuk ndryshon vlerësimin e përgjithshëm pozitiv, por që sugjeron hapësira të kufizuara për reflektim dhe përmirësim të mëtejshëm.

Tabela 8 Procesi i orientimit për studentët e rinj

Procesi i orientimit për studentët e rinj ishte i qartë dhe i dobishëm për të kuptuar mënyrën e funksionimit të universitetit					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1	7	2.8	2.8	2.8
	2	9	3.6	3.6	6.5
	3	56	22.6	22.6	29.0
	4	80	32.3	32.3	61.3
	5	96	38.7	38.7	100.0
Total		248	100.0	100.0	

Ky rezultat konfirmon orientimin e studentëve të rinj si një praktikë funksionale dhe të konsoliduar. Vijimi i kësaj qasjeje, së bashku me reflektim selektiv mbi përmbajtjen dhe mënyrën e organizimit të orientimit, mund të kontribuojë në adresimin më të mirë të pritshmërive të grupit neutral, nëse kjo vlerësohet e përshtatshme nga strukturat përgjegjëse.

Procesi i regjistrimit në UMT

Procesi i regjistrimit vlerësohet në mënyrë *shumë pozitive* nga studentët, duke reflektuar një përvojë administrative të qartë, të strukturuar dhe funksionale. *78.6% e respondentëve* shprehen dakord ose plotësisht dakord (vlerësimet 4 dhe 5), çka tregon se për shumicën dërrmuese regjistrimi është perceptuar si i thjeshtë dhe pa pengesa të rëndësishme. Veçanërisht e lartë është përqindja e vlerësimit maksimal (51.6%), një tregues i fortë i efikasitetit dhe qartësisë së procedurave të ndjekura.

Një pjesë *17.7% e studentëve* mbeten në qëndrim neutral, duke sugjeruar se, ndonëse procesi ka qenë funksional, ai nuk ka krijuar domosdoshmërisht një përvojë dalluese për të gjithë. Ndërkohë, *vetëm 3.6%* shprehen në mosdakordësi (vlerësimet 1 dhe 2), një përqindje shumë e ulët që nuk ndikon në vlerësimin e përgjithshëm pozitiv të këtij treguesi. Në tërësi, rezultati konfirmon funksionimin efektiv të procesit të regjistrimit dhe kontributin e tij në krijimin e një përvoje fillestare të qëndrueshme për studentët.

Tabela 9 Procesi i regjistrimit në UMT

Procesi i regjistrimit në UMT ishte i thjeshtë, i qartë dhe pa pengesa					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1	2	.8	.8	.8
	2	7	2.8	2.8	3.6
	3	44	17.7	17.7	21.4
	4	67	27.0	27.0	48.4
	5	128	51.6	51.6	100.0
	Total	248	100.0	100.0	

Ky vlerësim pozitiv sugjeron se procesi i regjistrimit përbën një nga pikat e forta të shërbimeve administrative. Rekomandohet vijimi i kësaj qasjeje, duke ruajtur qartësinë procedurale dhe gatishmërinë për mbështetje. Për grupin neutral, sugjerohet që në analizat pasuese të shihen indikatorë të thjeshtë të përvojës së regjistrimit (p.sh. pyetjet më të shpeshta, kërkesat për asistencë, ose vërejtjet e raportuara), me qëllim identifikimin e atyre hapave që kërkojnë sqarim shtesë, nëse kjo vlerësohet e përshtatshme nga strukturat përgjegjëse.

Platforma online (Edu4School)

Platforma online e UMT vlerësohet në mënyrë *qartësisht pozitive* për funksionalitetin dhe përdorshmërinë e saj në informimin akademik dhe regjistrimin e lëndëve. *75.4% e studentëve* shprehen dakord ose plotësisht dakord (vlerësimet 4 dhe 5), me një peshë të lartë të vlerësimit maksimal (47.2%), çka tregon se për shumicën dërrmuese platforma perceptohet si e lehtë për t'u përdorur dhe e dobishme në praktikë. Ky rezultat sinjalizon një nivel të mirë të dizajnit funksional

dhe të integritit të platformës në proceset akademike të përditshme (Tabela 10).

18.1% e studentëve pozicionohet në qëndrim neutral, duke sugjeruar se për një pjesë të tyre përvoja me platformën ka qenë e kënaqshme, por jo domosdoshmërisht optimale në çdo aspekt. Ndërkohë, 6.4% e vlerësimeve negative (1 dhe 2) mbeten në nivele të ulëta dhe nuk e ndryshojnë leximin e përgjithshëm pozitiv, por ofrojnë sinjale të kufizuara për reflektim të mëtejshëm.

Tabela 10 Platforma online (Edu4School)

Platforma online (Edu4School) e UMT për informacione akademike dhe regjistrimin e lëndëve është e lehtë për t'u përdorur dhe e dobishme					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1	4	1.6	1.6	1.6
	2	12	4.8	4.8	6.5
	3	45	18.1	18.1	24.6
	4	70	28.2	28.2	52.8
	5	117	47.2	47.2	100.0
	Total	248	100.0	100.0	

Ky vlerësim pozitiv tregon se platforma Edu4School përbën një komponent funksional dhe të konsoliduar të shërbimeve akademike. Në vijimësi, dhe nëse vlerësohet e nevojshme nga strukturat përgjegjëse, krahas manualit digjital ekzistues për përdorimin e platformës, mund të forcohet edhe komponenti orientues për studentët e viteve të para, përmes sesioneve të shkurtra udhëzuese ose rikujtuese mbi funksionet kryesore të platformës. Një qasje e tillë do të ndihmonte në adresimin e nevojave të grupit neutral dhe në parandalimin e vështirësive të mundshme në përdorimin e saj në fazat e para të studimeve, pa ndryshuar logjikën aktuale të funksionimit të sistemit.

Informimi mbi të drejtat dhe detyrimet e studentëve

Perceptimi i studentëve mbi informimin për të drejtat dhe detyrimet e tyre paraqitet *qartësisht pozitiv*. 75.8% e tyre shprehen dakord ose plotësisht dakord (vlerësimet 4 dhe 5), me një peshë të lartë të vlerësimit maksimal (48.4%), duke treguar se informacioni i ofruar është, në shumicën e rasteve, i qartë dhe i kuptueshëm. Kjo sugjeron funksionimin e mirë të mekanizmave informues dhe një komunikim të qëndrueshëm institucional në këtë drejtim.

18.1% e studentëve pozicionohet në qëndrim neutral, çka nënkupton se, ndonëse informacioni është marrë, ai mund të mos jetë përvetësuar plotësisht ose të mos ketë qenë i njëjtë në intensitet për të gjithë. Ndërkohë, 6.0% shprehen në mosdakordësi (vlerësimet 1 dhe 2), një nivel i ulët që nuk cenon vlerësimin e përgjithshëm pozitiv, por sinjalizojnë nevojën për vëmendje të vazhdueshme ndaj mënyrës dhe kohës së komunikimit.

Tabela 11 Informimi mbi të drejtat dhe detyrimet e studentëve

Jam informuar qartë mbi të drejtat dhe detyrimet e mia si student në UMT					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1	4	1.6	1.6	1.6
	2	11	4.4	4.4	6.0
	3	45	18.1	18.1	24.2
	4	68	27.4	27.4	51.6
	5	120	48.4	48.4	100.0
	Total	248	100.0	100.0	

Ky vlerësim pozitiv konfirmon qartësinë e informacionit të ofruar mbi të drejtat dhe detyrimet e studentëve. Në vijimësi, dhe nëse vlerësohet e përshtatshme nga strukturat përgjegjëse, mund të forcohet koherenca e këtij informacioni përmes shpërndarjes së tij të qëndrueshme si gjatë procesit të pranimit, ashtu edhe gjatë javës së orientimit, si dhe përmes rikujtimeve të strukturuar në fazat e para të vitit akademik. Një qasje e tillë do të ndihmonte veçanërisht në adresimin e grupit neutral dhe në rritjen e përvetësimit praktik të këtij informacioni, pa ndryshuar kornizën aktuale rregullatore.

Qartësia dhe zbatueshmëria e rregulloreve dhe politikave të universitetit

Rregulloret dhe politikat e universitetit vlerësohen në mënyrë përgjithësisht pozitive, duke reflektuar një kuadër normativ të perceptuar si i qartë dhe i zbatueshëm nga shumica e studentëve. 71.0% e respondentëve shprehen dakord ose plotësisht dakord (vlerësimet 4 dhe 5), me një peshë të konsiderueshme të vlerësimit maksimal (44.4%), çka tregon se dokumentet rregullatore dhe politikat institucionale janë, në masë të madhe, të kuptueshme dhe të lehta për t'u ndjekur në praktikë.

23.4% e studentëve pozicionohet në qëndrim neutral, duke sugjeruar se, edhe pse rregulloret njihen dhe pranohen, përvetësimi i tyre praktik mund të mos jetë i njëjtë për të gjithë ose të kërkojë kohë dhe përvijë gjatë studimeve. Ndërkohë, 5.6% e vlerësimeve negative (1 dhe 2) mbeten në nivele të ulëta dhe nuk ndikojnë në leximin e përgjithshëm pozitiv të këtij treguesi.

Tabela 12 Qartësia dhe zbatueshmëria e rregulloreve dhe politikave të universitetit

Rregulloret dhe politikat e universitetit janë të qarta dhe të lehta për t'u ndjekur				
	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent

Valid	1	5	2.0	2.0	2.0
	2	9	3.6	3.6	5.6
	3	58	23.4	23.4	29.0
	4	66	26.6	26.6	55.6
	5	110	44.4	44.4	100.0
	Total	248	100.0	100.0	

Ngjashëm me vlerësimin e pohimit të mëparshëm, ky rezultat sugjeron se qartësia formale e rregulloreve dhe politikave është e konsoliduar. Në vijimësi, mund të forcohet komunikimi i përmbajtjes së tyre përmes theksimit të pikave kyçe gjatë procesit të pranimit dhe javës së orientimit, si dhe përmes përmbledhjeve orientuese ose rikujtimeve periodike që ndihmojnë studentët në zbatimin praktik të rregulloreve gjatë fazave të ndryshme të studimeve. Kjo qasje do të kontribuonte në rritjen e përvetësimit funksional, veçanërisht për grupin neutral, pa vënë në diskutim kornizën ekzistuese rregullatore.

Udhëzimi për përdorimin e platformave teknologjike

Vlerësimi i studentëve mbi udhëzimet për përdorimin e platformave teknologjike të universitetit paraqitet *përgjithësisht pozitiv*. 71.3% e respondentëve shprehën dakord ose plotësisht dakord (vlerësimet 4 dhe 5), me një peshë të lartë të vlerësimit maksimal (43.5%), duke treguar se për shumicën e studentëve informacioni dhe mbështetja e ofruar kanë qenë të mjaftueshme për përdorimin e këtyre platformave në praktikë. Ky rezultat sugjeron se mekanizmat aktualë të orientimit dhe informimit funksionojnë në mënyrë efektive në mbështetje të proceseve akademike dhe administrative.

23.0% e studentëve pozicionohet në qëndrim neutral, çka tregon se, ndonëse udhëzimet janë ofruar, niveli i përvetësimit ose i sigurisë në përdorim mund të mos jetë i njëjtë për të gjithë. Ndërkohë, 5.6% e vlerësimeve negative (1 dhe 2) mbeten në nivele të ulëta dhe nuk e cenojnë vlerësimin e përgjithshëm pozitiv të këtij treguesi.

Tabela 13 Udhëzimi për përdorimin e platformave teknologjike

Kam marrë udhëzime të mjaftueshme për përdorimin e platformave teknologjike të universitetit					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1	6	2.4	2.4	2.4
	2	8	3.2	3.2	5.6
	3	57	23.0	23.0	28.6
	4	69	27.8	27.8	56.5
	5	108	43.5	43.5	100.0
	Total	248	100.0	100.0	

Ky vlerësim pozitiv konfirmon funksionalitetin e qasjes aktuale në udhëzimin e studentëve për përdorimin e platformave teknologjike. Në vijimësi, dhe nëse vlerësohet e nevojshme/e

përshtatshme nga strukturat përgjegjëse, krahas udhëzuesve dhe manualeve digjitale ekzistuese, mund të forcohet komponenti orientues përmes sesioneve të shkurtra trajnuese ose rikujtuese për përdorimin e Edu4School dhe platformave të tjera të ngjashme që përdoren nga institucioni. Një qasje e tillë do të ndihmonte veçanërisht në adresimin e nevojave të grupit neutral dhe në rritjen e sigurtisë së studentëve në përdorimin praktik të këtyre mjeteve, pa ndryshuar logjikën aktuale të funksionimit të sistemit.

Infrastruktura teknologjike e UMT

Infrastruktura teknologjike e UMT vlerësohet **pozitivisht** nga studentët, duke reflektuar një nivel funksionaliteti që, në përgjithësi, përmbush nevojat e tyre akademike. 73.7% e respondentëve shprehën dakord ose plotësisht dakord (vlerësimet 4 dhe 5), çka tregon se shërbimet si Wi-Fi, pajisjet kompjuterike dhe laboratorët perceptohen si të mjaftueshme dhe të përdorshme në praktikë. Ky rezultat sinjalizon një bazë teknologjike të qëndrueshme që mbështet procesin mësimor dhe aktivitetet akademike të përditshme (Tabela 14).

18.1% e studentëve pozicionohet në qëndrim neutral, duke sugjeruar se, ndonëse infrastruktura plotëson kërkesat bazë, përvoja mund të mos ketë qenë e njëjtë për të gjithë në çdo kontekst ose hapësirë. Ndërkohë, 8.0% e vlerësimeve negative (1 dhe 2) mbeten në nivele të kufizuara dhe nuk e ndryshojnë leximin e përgjithshëm pozitiv të këtij treguesi.

Tabela 14 Infrastruktura teknologjike e UMT

Infrastruktura teknologjike e UMT, (Wi-Fi, kompjuterë, laboratorë, etj.) përmbush nevojat e studentëve					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1	8	3.2	3.2	3.2
	2	12	4.8	4.8	8.1
	3	45	18.1	18.1	26.2
	4	108	43.5	43.5	69.8
	5	75	30.2	30.2	100.0
	Total	248	100.0	100.0	

Ky rezultat sugjeron se infrastruktura teknologjike e UMT funksionon në mënyrë të qëndrueshme dhe në përputhje me nevojat aktuale të studentëve. Në këtë fazë, vlerësimet nuk sinjalizojnë çështje që kërkojnë ndërhyrje të menjëhershme, ndërsa ruajtja e standardeve ekzistuese dhe vëmendja e vazhdueshme ndaj funksionimit të përditshëm mbeten elementë kyç për sigurimin e kësaj përvoje pozitive edhe në vijimësi.

Orari i leksioneve dhe seminareve

Orari i leksioneve dhe seminareve vlerësohet **pozitivisht** nga studentët, duke reflektuar një organizim që në përgjithësi është i përshtatshëm dhe i lehtë për t'u ndjekur. 79.8% e respondentëve

shprehen dakord ose plotësisht dakord (vlerësimet 4 dhe 5), me një peshë veçanërisht të lartë të vlerësimit maksimal (54.0%), çka tregon se struktura e orarit i përgjigjet mirë nevojave akademike dhe ritmit të studentëve. Ky rezultat sinjalizon një koordinim efektiv ndërmjet njësive akademike dhe administratës për organizimin e procesit mësimor.

16.5% e studentëve pozicionohet në qëndrim neutral, duke sugjeruar se për një pjesë të kufizuar të studentëve orari ka qenë funksional, por jo domosdoshmërisht optimal në çdo rast. Ndërkohë, *3.6% e vlerësimeve negative* (1 dhe 2) mbeten minimale dhe nuk ndikojnë në leximin e përgjithshëm pozitiv të këtij treguesi.

Tabela 15 Orari i leksioneve dhe seminareve

Orari i leksioneve dhe seminareve është i përshtatshëm dhe i lehtë për t'u ndjekur					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1	1	.4	.4	.4
	2	8	3.2	3.2	3.6
	3	41	16.5	16.5	20.2
	4	64	25.8	25.8	46.0
	5	134	54.0	54.0	100.0
	Total	248	100.0	100.0	

Ky vlerësim shumë pozitiv sugjeron se organizimi i orarit përbën një praktikë të qëndrueshme dhe funksionale. Ruajtja e këtij niveli koordinimi dhe fleksibiliteti mbetet e rëndësishme për garantimin e një përvoja akademike të qëndrueshme edhe në vijimësi.

Pastërtia dhe mirëmbajtja e ambienteve të UMT

Pastërtia dhe mirëmbajtja e ambienteve të universitetit *vlerësohen pozitivisht* nga studentët, duke reflektuar një mjedis fizik të rregullt dhe të përshtatshëm për zhvillimin e veprimtarive akademike. *80.6% e respondentëve shprehen dakord ose plotësisht dakord* (vlerësimet 4 dhe 5), me një peshë të lartë të vlerësimit maksimal (54.4%), çka tregon se shumica e studentëve e perceptojnë nivelin e pastërtisë dhe mirëmbajtjes si të kënaqshëm dhe të qëndrueshëm. Ky rezultat sinjalizon funksionimin efektiv të shërbimeve mbështetëse që lidhen me administrimin e hapësirave universitare.

14.1% e tyre pozicionohet në qëndrim neutral, duke sugjeruar se për një pjesë të kufizuar të studentëve përvoja ka qenë e pranueshme, por jo domosdoshmërisht dalluese. Ndërkohë, *5.2% e vlerësimeve negative* (1 dhe 2) mbeten në nivele të ulëta.

Tabela 16 Pastërtia dhe mirëmbajtja e ambienteve të UMT

Pastërtia dhe mirëmbajtja e ambienteve të UMT janë në nivel të kënaqshëm				
	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent

Valid	1	5	2.0	2.0	2.0
	2	8	3.2	3.2	5.2
	3	35	14.1	14.1	19.4
	4	65	26.2	26.2	45.6
	5	135	54.4	54.4	100.0
	Total	248	100.0	100.0	

Ky rezultat sugjeron se standardet aktuale të pastërtisë dhe mirëmbajtjes janë të konsoliduara dhe kontribuojnë në krijimin e një mjedisi të përshtatshëm universitar. Ruajtja e këtij niveli përmes vëmendjes së vazhdueshme ndaj mirëmbajtjes së përditshme dhe menaxhimit të hapësirave mbetet një element i rëndësishëm për përvojën pozitive të studentëve edhe në vijimësi.

Cilësia e mësimdhënies në UMT

Cilësia e mësimdhënies në UMT vlerësohet qartësisht pozitive, duke reflektuar përmbushjen e pritshmërive akademike të shumicës së studentëve. 81.4% e tyre shprehen dakord ose plotësisht dakord (vlerësimet 4 dhe 5), me një shpërndarje të balancuar mes vlerësimit “dakord” (41.5%) dhe “plotësisht dakord” (39.9%). Ky rezultat tregon se procesi mësimor perceptohet si cilësor, i strukturuar dhe në përputhje me pritshmëritë që studentët kanë ndërtuar ndaj institucionit.

14.9% e studentëve pozicionohet në qëndrim neutral, duke sugjeruar se për një pjesë të kufizuar përvoja mësimore ka qenë e kënaqshme, por jo domosdoshmërisht dalluese në të gjitha aspektet. Ndërkohë, 3.6% e vlerësimeve negative (1 dhe 2) mbeten minimale dhe nuk ndikojnë në leximin e përgjithshëm pozitiv të këtij treguesi. Në tërësi, të dhënat konfirmojnë një perceptim të qëndrueshëm pozitiv mbi cilësinë e mësimdhënies (Tabela 17).

Tabela 17 Cilësia e mësimdhënies në UMT

Cilësia e mësimdhënies në UMT përmbush pritshmëritë e mia si student					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1	3	1.2	1.2	1.2
	2	6	2.4	2.4	3.6
	3	37	14.9	14.9	18.5
	4	103	41.5	41.5	60.1
	5	99	39.9	39.9	100.0
	Total	248	100.0	100.0	

Ky vlerësim pozitiv sugjeron se mësimdhënia përbën një nga shtyllat kryesore të përvojës akademike në UMT. Ruajtja e këtij niveli cilësie, së bashku me monitorimin e vazhdueshëm përmes të dhënave të mbledhura nga instrumentet e vlerësimit të lëndëve dhe performancës së pedagogëve, mundëson identifikimin në kohë të praktikave të mira dhe të hapësirave për zhvillim të mëtejshëm, pa cenuar autonominë akademike.

***Përmbledhje e rezultateve mbi përvojat funksionale dhe
operacionale të studentëve***

Në tërësi, kjo pjesë e fushës III pasqyron një *funksionim të qëndrueshëm dhe efektiv të proceseve operacionale të universitetit*, ku perceptimi i studentëve është kryesisht pozitiv në raport me qartësinë e procedurave administrative, përdorshmërinë e platformave teknologjike, organizimin e mësimdhënies, kushtet infrastrukturore dhe mjedisin universitar.

Vlerësimet e larta në shumicën e pohimeve tregojnë se shërbimet dhe mekanizmat mbështetës arrijnë, në përgjithësi, përmbushin pritshmëritë e studentëve dhe të garantojnë një përvojë funksionale gjatë vijimit të studimeve.

Prania e një grupi neutral në disa tregues nuk cenon këtë vlerësim pozitiv, por krijon hapësirë për *reflektim të kujdesshëm dhe përmirësim të moderuar*, aty ku kjo vlerësohet e arsyeshme nga drejtuesit dhe përfaqësuesit e strukturave përkatëse. Në këtë kuadër, sugjerimet e bëra lidhen kryesisht me *forcimin e komponentit orientues dhe informues në fazat e hershme të studimeve, theksimin e komunikimit praktik mbi rregulloret dhe procedurat, si dhe plotësimin e udhëzuesve digjitalë me forma mbështetëse orientimi ose rikujtimi*, pa cenuar kornizën dhe praktikën aktuale të funksionimit institucional.

SHËRBIMET AKADEMIKE DHE ADMINISTRATIVE

Kjo nën-fushë fokusohet në vlerësimin e përvojës së studentëve në raport me shërbimet akademike dhe administrative që mbështesin drejtpërdrejt vijimin e studimeve dhe organizimin e tyre në praktikë. Pohimet përkatëse adresojnë efikasitetin e *sekretarisë mësimore, rolin mbështetës të koordinatorëve të fakultetit, funksionin e këshillimit akademik në planifikimin e studimeve, si dhe qartësinë e procesit të regjistrimit të lëndëve*. Në këtë kuptim, kjo pjesë ofron një pasqyrë të rëndësishme mbi mënyrën se si studentët e perceptojnë ndërveprimin e përditshëm me strukturat që kanë rol kyç në orientimin, informimin dhe mbështetjen akademike, duke reflektuar nivelin e funksionalitetit dhe të aksesueshmërisë së këtyre shërbimeve.

Sekretaria mësimore

Vlerësimi i studentëve për sekretarinë mësimore është *qartësisht pozitiv*, duke reflektuar një perceptim të mirë mbi efikasitetin dhe gatishmërinë e kësaj strukture për të mbështetur studentët në çështjet akademike dhe administrative. *79.1% e tyre shprehen dakord ose plotësisht dakord* (vlerësimet 4 dhe 5), me një peshë të konsiderueshme të vlerësimit maksimal (45.2%), çka tregon se për shumicën dërrmuese sekretaria mësimore funksionon si një pikë kontakti e besueshme dhe funksionale në përditshmërinë universitare. Ky rezultat nënvizon rolin kyç të kësaj zyre në garantimin e qartësisë procedurale dhe në lehtësimin e ndërveprimit student–institutcion.

15.7% e studentëve pozicionohet në qëndrim neutral, duke sugjeruar se, ndonëse shërbimi perceptohet si i kënaqshëm, përvoja nuk ka qenë njësoj pozitive për të gjithë ose ka qenë më shumë funksionale sesa dalluese. Ndërkohë, *5.2% e vlerësimeve negative* (1 dhe 2) mbeten në nivele të ulëta dhe nuk ndikojnë në leximin e përgjithshëm pozitiv të këtij treguesi.

Tabela 18 Sekretaria mësimore

Sekretaria mësimore është efikase dhe e gatshme për të ndihmuar studentët					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1	4	1.6	1.6	1.6
	2	9	3.6	3.6	5.2
	3	39	15.7	15.7	21.0
	4	84	33.9	33.9	54.8
	5	112	45.2	45.2	100.0
	Total	248	100.0	100.0	

Ky vlerësim pozitiv konfirmon sekretarinë mësimore si një nga strukturat mbështetëse funksionale të institucionit. Në vijimësi, dhe nëse vlerësohet e arsyeshme/ e nevojshme nga drejtuesit e strukturave përkatëse, mund të konsiderohet forcimi i kompetencave të personelit përmes trajnimeve të synuara në komunikimin me studentët, menaxhimin e flukseve të kërkesave dhe përdorimin e sistemeve digjitale, me qëllim rritjen e mëtejshme të cilësisë së shërbimit dhe

adresimin më të mirë të nevojave të grupit neutral.

Koordinatori i fakultetit

Roli i koordinatorit të fakultetit *vlerësohet pozitivisht* nga studentët, duke reflektuar një perceptim të mirë mbi mbështetjen dhe udhëzimet e ofruara gjatë vijimit të studimeve. *68.9% e respondentëve shprehën dakord ose plotësisht dakord* (vlerësimet 4 dhe 5), me një peshë të konsiderueshme të vlerësimit maksimal (41.1%), çka tregon se për shumicën e studentëve koordinatori funksionon si një pikë referimi e dobishme për orientimin akademik dhe zgjidhjen e çështjeve praktike. Ky rezultat nënvizon rëndësinë e këtij roli ndërmjetësues mes studentëve dhe strukturave akademike.

23.8% e studentëve pozicionohet në qëndrim neutral, duke sugjeruar se për një pjesë të konsiderueshme mbështetja ka qenë e pranishme, por jo domosdoshmërisht e njëjtë në intensitet ose frekuencë për të gjithë. Ndërkohë, *7.3% e vlerësimeve negative* (1 dhe 2) mbeten në nivele të kufizuara dhe nuk e ndryshojnë leximin e përgjithshëm pozitiv të këtij treguesi. (Tabela 19)

Tabela 19 Koordinatori i fakultetit

Koordinatori i fakultetit ofron mbështetje dhe udhëzime të dobishme për studentët					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1	8	3.2	3.2	3.2
	2	10	4.0	4.0	7.3
	3	59	23.8	23.8	31.0
	4	69	27.8	27.8	58.9
	5	102	41.1	41.1	100.0
	Total	248	100.0	100.0	

Ky vlerësim pozitiv konfirmon funksionin mbështetës të koordinatorit të fakultetit në përvojën akademike të studentëve. Në vijimësi, mund të forcohet më tej ky rol përmes qartësimit të pritshmërive ndaj funksionit të koordinatorit dhe harmonizimit të praktikave të komunikimit dhe orientimit, me synim adresimin më të mirë të nevojave të grupit neutral dhe rritjen e koherencës së përvojës studentore.

Këshillimi akademik (përgjegjësit e programeve / këshilltarët akademikë)

Këshillimi akademik vlerësohet *qartësisht pozitiv*, duke reflektuar rolin e tij të dobishëm në orientimin dhe planifikimin e studimeve. 78.2% e respondentëve shprehen dakord ose plotësisht dakord (vlerësimet 4 dhe 5), me një peshë të lartë të vlerësimit maksimal (43.5%), çka tregon se për shumicën e studentëve mbështetja e ofruar ka qenë funksionale dhe e vlefshme në marrjen e vendimeve akademike. Ky rezultat nënvizon rëndësinë e këshillimit akademik si mekanizëm orientues gjatë vijimit të studimeve.

17.3% e studentëve pozicionohet në qëndrim neutral, duke sugjeruar se, ndonëse këshillimi është i pranishëm, intensiteti, qartësia ose koha e ndërveprimit mund të mos kenë qenë të njëjta për të gjithë. Ndërkohë, 4.4% e vlerësimeve negative (1 dhe 2) mbeten në nivele të ulëta.

Tabela 20 Këshillimi akademik (përgjegjësit e programeve / këshilltarët akademikë)

Këshillimi akademik është i dobishëm dhe ndihmon në planifikimin e studimeve					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1	4	1.6	1.6	1.6
	2	7	2.8	2.8	4.4
	3	43	17.3	17.3	21.8
	4	86	34.7	34.7	56.5
	5	108	43.5	43.5	100.0
	Total	248	100.0	100.0	

Ky vlerësim pozitiv konfirmon funksionalitetin e këshillimit akademik në mbështetje të planifikimit të studimeve. Në vijimësi, mund të forcohet koherenca e këtij shërbimi përmes strukturimit më të njëtrajtshëm të takimeve orientuese dhe theksimit të ndërveprimit në fazat kyçe të ciklit të studimeve, me synim adresimin më të mirë të nevojave të grupit neutral dhe rritjen e përfitimit praktik për studentët.

Procesi i regjistrimit të lëndëve

Procesi i regjistrimit të lëndëve vlerësohet **shumë pozitivisht** nga studentët, duke reflektuar një procedurë të qartë, të kuptueshme dhe lehtësisht të zbatueshme në praktikë. **80.2% e respondentëve** shprehen dakord ose plotësisht dakord (vlerësimet 4 dhe 5), me një shpërndarje pothuajse të barabartë mes vlerësimit “dakord” (39.5%) dhe “plotësisht dakord” (40.7%), çka tregon një nivel të lartë kënaqësie dhe funksionaliteti të këtij procesi administrativ. Ky rezultat sugjeron se procedurat dhe udhëzimet për regjistrimin e lëndëve janë të strukturuar mirë dhe i

përgjigjen nevojave të studentëve gjatë organizimit të studimeve të tyre.

Një **16.5%** e studentëve pozicionohet në qëndrim neutral, duke treguar se, ndonëse procesi është funksional, për një pjesë të tyre ai nuk ka qenë domosdoshmërisht dallues ose plotësisht i qartë në çdo hap. Ndërkohë, **3.2%** e vlerësimeve negative (1 dhe 2) mbeten minimale dhe nuk ndikojnë në vlerësimin e përgjithshëm pozitiv të këtij treguesi. (Tabela 21)

Tabela 21 Procesi i regjistrimit të lëndëve

Procesi i regjistrimit të lëndëve është i qartë dhe i lehtë për t'u ndjekur					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1	2	.8	.8	.8
	2	6	2.4	2.4	3.2
	3	41	16.5	16.5	19.8
	4	98	39.5	39.5	59.3
	5	101	40.7	40.7	100.0
	Total	248	100.0	100.0	

Ky vlerësim pozitiv konfirmon procesin e regjistrimit të lëndëve si një praktikë të konsoliduar dhe funksionale. Në vijimësi, dhe nëse vlerësohet e përshtatshme nga strukturat përgjegjëse, ruajtja e qartësisë procedurale, e shoqëruar me analizën e rasteve më të shpeshta të kërkesave për sqarim gjatë periudhave të regjistrimit, mund të ndihmojë në rritjen e mëtejshme të efektivitetit të këtij procesi, pa ndryshuar logjikën aktuale të funksionimit të tij.

Përmbledhje mbi vlerësimin e shërbimeve akademike dhe administrative

Në tërësi, kjo nën-fushë pasqyron një *perceptim pozitiv dhe të qëndrueshëm të studentëve* lidhur me shërbimet akademike dhe administrative që mbështesin vijimin e studimeve.

Vlerësimet e larta për sekretarinë mësimore, rolin e koordinatorit të fakultetit, këshillimin akademik dhe procesin e regjistrimit të lëndëve tregojnë se këto struktura funksionojnë, në përgjithësi, në mënyrë efektive, të aksesueshme dhe në përputhje me nevojat praktike të studentëve.

Prania e një grupi neutral në disa tregues nuk e cenon këtë vlerësim pozitiv, por ofron sinjale të dobishme për reflektim të moderuar; në këtë kuadër, sugjerimet e bëra lidhen kryesisht me *forcimin e koherencës së komunikimit, strukturimin më të njëtrajtshëm të ndërveprimit orientues dhe analizën e kërkesave më të shpeshta për sqarim*, aty ku kjo vlerësohet e arsyeshme nga drejtuesit dhe përfaqësuesit e strukturave përkatëse, me synim rritjen e mëtejshme të përvojës studentore pa ndryshuar praktikën bazë të funksionimit aktual.

NJOHJA ME MUNDËSITË JASHTË KURRIKULËS

Kjo nën-fushë fokusohet në vlerësimin e nivelit të informimit dhe përfshirjes së studentëve në mundësitë jashtë kurrikulës që ofron universiteti, duke përfshirë *klubet studentore, aktivitetet jashtë mësimore, shërbimet e këshillimit për karrierë dhe mjedisin social* që mbështet integrimin universitar. Pohimet përkatëse adresojnë drejtpërdrejt mënyrën se si studentët e perceptojnë komunikimin, organizimin dhe nxitjen e këtyre aktiviteteve nga strukturat që kanë përgjegjësi për jetën studentore.

Në këtë kuadër, vëmendja analitike i drejtohet rolit të strukturave që merren me *organizimin dhe koordinimin e aktiviteteve jashtë kurrikulës*, përfshirë *dekanatin e studentëve*, si dhe *njësitë apo shërbimet që kontribuojnë në informimin, orientimin dhe mbështetjen e angazhimit studentor përtej procesit mësimor*. Këto struktura luajnë një rol kyç në krijimin e mundësive për pjesëmarrje aktive, në ndërtimin e komunitetit universitar dhe në forcimin e përvojës studentore në tërësi.

Njohja me klubet studentore dhe aktivitetet jashtë mësimore

Rezultatet për këtë pohim tregojnë një vlerësim përgjithësisht pozitiv të nivelit të informimit të studentëve mbi klubet studentore dhe aktivitetet jashtë mësimore që ofron UMT. Në total, 67.8% e studentëve shprehen dakord ose plotësisht dakord (vlerësimet 4 dhe 5), me një peshë të lartë të vlerësimit maksimal (45.2%), çka sugjeron se për shumicën e studentëve informacioni për këto mundësi ka qenë i pranishëm dhe i kuptueshëm. Ky rezultat tregon se universiteti ka krijuar kanale funksionale komunikimi për promovimin e jetës jashtë kurrikulës.

Njëkohësisht, 22.2% e studentëve pozicionohen në qëndrim *neutral*, duke sinjalizuar se, ndonëse informacioni ekziston, ai mund të mos ketë qenë i mjaftueshëm, i njëtrajtshëm ose i lidhur drejtpërdrejt me interesat e të gjithë studentëve. Vlerësimet negative (10.1%) mbeten në nivele të kufizuara. (Tabela 22)

Tabela 22 Njohja me klubet studentore dhe aktivitetet jashtë mësimore

Jam informuar rreth klubeve studentore dhe aktiviteteve jashtë mësimore					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1	11	4.4	4.4	4.4
	2	14	5.6	5.6	10.1
	3	55	22.2	22.2	32.3
	4	56	22.6	22.6	54.8
	5	112	45.2	45.2	100.0
	Total	248	100.0	100.0	

Në vijimësi, dhe pa vënë në diskutim funksionimin aktual të këtyre praktikave, mund të merret në konsideratë zgjerimi dhe diversifikimi i mekanizmave të komunikimit dhe prezantimit të

aktiviteteve jashtë mësimore. Në këtë drejtim, forcimi i sesioneve informuese gjatë javës së orientimit, si dhe përdorimi i formave plotësuese të komunikimit të vazhdueshëm gjatë vitit akademik, si prezantime periodike të aktiviteteve në platformat digjitale të institucionit, rubrika të dedikuara informuese në kanalet zyrtare online, njoftime tematike të strukturuar sipas interesave studentore, si edhe përfshirja e studentëve aktivë si ambasadorë të jetës jashtë kurrikulës, me synim rritjen e dukshmërisë dhe të përfshirjes reale, mund të kontribuojnë në rritjen e ndërgjegjësimit dhe në përfshirjen më aktive të studentëve, veçanërisht të atyre që aktualisht shfaqen në pozicion neutral.

Aktivitetet e organizuara nga dekanati i studentëve

Vlerësimi i studentëve për aktivitetet e organizuara nga dekanati i studentëve është përgjithësisht pozitiv dhe tregon një rol të dukshëm të këtyre aktiviteteve në integrimin universitar. Në total, 63.8% e studentëve shprehen dakord ose plotësisht dakord (vlerësimet 4 dhe 5) se aktivitetet janë tërheqëse dhe të dobishme, me një peshë të konsiderueshme të vlerësimit maksimal (44.0%). Ky rezultat sugjeron se për një pjesë të madhe të studentëve, aktivitetet e organizuara kontribuojnë realisht në ndërtimin e përvojës sociale universitare dhe në forcimin e ndjenjës së përkatësisë institucionale.

Nga ana tjetër, 26.6% e studentëve mbeten në qëndrim neutral, çka tregon se, ndonëse aktivitetet perceptohen pozitivisht, për një pjesë të studentëve ato mund të mos jenë plotësisht të njohura, të aksesueshme ose të përshtatura me interesat e tyre specifike. Vlerësimet negative mbeten në nivele të ulëta (9.7%) dhe nuk cenojnë leximin e përgjithshëm pozitiv të këtij treguesi.

Tabela 23 Aktivitetet e organizuara nga dekanati i studentëve

Aktivitetet e organizuara nga dekanati i studentëve janë tërheqëse dhe të dobishme për integrimin universitar					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1	14	5.6	5.6	5.6
	2	10	4.0	4.0	9.7
	3	66	26.6	26.6	36.3
	4	49	19.8	19.8	56.0
	5	109	44.0	44.0	100.0
	Total	248	100.0	100.0	

Në këtë kontekst, duke u mbështetur në vlerësimin përgjithësisht pozitiv të studentëve, rekomandohet që praktikat ekzistuese të dekanatit të studentëve dhe strukturave përkatëse të vijojnë të konsolidohen dhe të sistematizohen më tej, përmes një artikulimi më të qartë të objektivave të aktiviteteve, ritmit të zhvillimit të tyre gjatë vitit akademik dhe lidhjes më të drejtpërdrejtë me nevojat akademike, sociale dhe profesionale të studentëve. Një qasje e tillë do të mundësonte jo domosdoshmërisht shtimin e aktiviteteve, por rritjen e dukshmërisë, koherencës dhe ndikimit të tyre, duke adresuar më mirë edhe pritshmëritë e grupit neutral, pa ndryshuar

modelin funksional aktual.

Informimi mbi mundësitë e këshillimit për karrierë

Vlerësimi i studentëve mbi informimin për mundësitë e këshillimit për karrierë në UMT paraqitet *pozitiv*, duke reflektuar funksionimin efektiv të mekanizmave orientues në këtë drejtim. *72.2% e respondentëve shprehen dakord ose plotësisht dakord* (vlerësimet 4 dhe 5), me një peshë të konsiderueshme të vlerësimit maksimal (44.8%), çka tregon se për shumicën e studentëve informacioni i ofruar është perceptuar si i qartë, i kuptueshëm dhe i dobishëm për orientimin profesional.

21.4% e studentëve në qëndrim neutral sugjeron se, ndonëse informacioni është i pranishëm, niveli i përvetësimit ose i ekspozimit ndaj këtij shërbimi mund të mos ketë qenë i njëjtë për të gjithë.

Tabela 24 Informimi mbi mundësitë e këshillimit për karrierë

Kam marrë informacion të qartë për mundësitë e këshillimit për karrierë në UMT					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1	10	4.0	4.0	4.0
	2	6	2.4	2.4	6.5
	3	53	21.4	21.4	27.8
	4	68	27.4	27.4	55.2
	5	111	44.8	44.8	100.0
	Total	248	100.0	100.0	

Në këtë kuadër, forcimi i komunikimit të vazhdueshëm mbi mundësitë e këshillimit për karrierë përgjatë gjithë ciklit të studimeve, përmes formateve të strukturuar informuese dhe rikujtuese, mund të kontribuojë në rritjen e dukshmërisë dhe përfitimit praktik të këtij shërbimi, pa vënë në diskutim qasjen pozitive aktuale të tij.

Mjedisi social dhe përfshirja në jetën jashtë mësimore

Perceptimi i studentëve mbi mjedisin social në UMT paraqitet *përgjithësisht pozitiv*, por njëkohësisht më i balancuar krahasuar me treguesit e tjerë të kësaj nën-fushe. *60.9% e respondentëve shprehen dakord ose plotësisht dakord* (vlerësimet 4 dhe 5) se mjedisi social i inkurajon të ndërtojnë marrëdhënie dhe të përfshihen në aktivitete jashtë mësimore, çka tregon se për një shumicë të konsiderueshme universiteti ofron një klimë sociale të hapur dhe mbështetëse për ndërveprim dhe angazhim studentor.

Megjithatë, *26.6% e studentëve në qëndrim neutral*, së bashku me *12.5% vlerësime negative*, sugjerojnë se për një pjesë jo të vogël të studentëve kjo përvojë nuk është përjetuar në mënyrë të njëtrajtshme ose të mjaftueshme për të nxitur përfshirje aktive. Ky rezultat sinjalizon se mjedisi social funksionon në mënyrë pozitive, por ndikimi i tij varet nga faktorë të tillë si ekspozimi ndaj

aktiviteteve, intensiteti i ndërveprimeve dhe mundësitë reale për pjesëmarrje. (Tabela 25)

Tabela 25 Mjedisi social dhe përfshirja në jetën jashtë mësimore

Mjedisi social në UMT më inkurajon të ndërtoj marrëdhënie dhe të përfshihem në aktivitete jashtë mësimore					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1	13	5.2	5.2	5.2
	2	18	7.3	7.3	12.5
	3	66	26.6	26.6	39.1
	4	59	23.8	23.8	62.9
	5	92	37.1	37.1	100.0
	Total	248	100.0	100.0	

Në këtë kuadër, ruajtja e klimës aktuale mbështetëse, e shoqëruar me forma të qëndrueshme nxitjeje të ndërveprimit studentor dhe të dukshmërisë së aktiviteteve sociale gjatë vitit akademik, mund të kontribuojë në rritjen e ndjenjës së përfshirjes dhe në adresimin gradual të pritshmërive të grupit neutral dhe atyre të pakënaqur.

Përmbledhje e vlerësimit mbi njohjen dhe përfshirjen në mundësitë jashtë kurrikulës

Kjo nën-fushë paraqet një *pamje përgjithësisht pozitive dhe funksionale* të mënyrës se si studentët informohen dhe përfshihen në jetën jashtë kurrikulës në UMT, duke përfshirë *klubet studentore, aktivitetet jashtë mësimore, shërbimet e këshillimit për karrierë dhe klimën sociale universitare*. Në shumicën e pohimeve, përqindjet e vlerësimeve pozitive (4 dhe 5) janë dominuese, çka tregon se mekanizmat ekzistues të komunikimit, organizimit dhe mbështetjes perceptohen si të pranishëm dhe të dobishëm nga studentët. Veçanërisht, aktivitetet e organizuara për integrimin universitar dhe informimi mbi këshillimin për karrierë konfirmohen si elemente që kontribuojnë realisht në përvojën studentore përtej procesit mësimor.

Njëkohësisht, *prania e qëndrimeve neutrale në të gjitha pohimet*, në nivele nga rreth një e pesta deri në mbi një të katërtën e respondentëve, sugjeron se ndikimi i këtyre mundësive nuk është përjetuar në mënyrë të njëtrajtshme nga të gjithë studentët. Kjo nuk e cenon vlerësimin pozitiv të përgjithshëm, por *sinjalizon hapësira për forcim të mëtejshëm të dukshmërisë, koherencës dhe ritmit të komunikimit*, si dhe *për një lidhje më të drejtpërdrejtë të aktiviteteve me interesat akademike, sociale dhe profesionale të studentëve*.

Në këtë kuptim, ruajtja e praktikave aktuale, e shoqëruar me një artikulum më të strukturuar dhe të vazhdueshëm të mundësive jashtë kurrikulës gjatë gjithë vitit akademik, mund të kontribuojë në rritjen e përfshirjes aktive dhe në konsolidimin e përvojës studentore në tërësi.

PËRMBLEDHJE SINTETIKE E PËRGJIGJEVE NË PYETJEN E HAPUR

Përgjigjet e studentëve në pyetjen e hapur reflektojnë, në tërësi, *një perceptim pozitiv dhe të qëndrueshëm* ndaj përvojës së tyre universitare në UMT. Një pjesë shumë e madhe e respondentëve zgjedhin të mos shtojnë komente apo sugjerime shtesë, duke u shprehur qartë se *nuk kanë shqetësime të veçanta* ose se *përvoja e tyre deri më tani është e kënaqshme*. Kjo prirje, e përsëritur në mënyrë të vazhdueshme në përgjigje të shumta, përforcon leximin se shërbimet akademike, infrastruktura dhe organizimi i përgjithshëm i studimeve perceptohen si funksionale dhe në përputhje me pritshmëritë e studentëve.

Në një numër më të kufizuar rastesh, studentët shprehin mendime që lidhen kryesisht me *aspekte praktike të përditshmërisë universitare*, të cilat nuk e vënë në diskutim cilësinë e përgjithshme të institucionit, por ofrojnë elemente reflektimi për përmirësime të natyrës organizative. Këto komente janë të shpërndara dhe të ndryshme në fokus, çka tregon se nuk kemi të bëjmë me problematika të konsoliduara ose sistemike, por me përvoja individuale dhe kontekstuale.

Në këtë kuadër, disa studentë prekin lehtë çështje që lidhen me *koordinimin e orareve*, veçanërisht në raport me aktivitetet jashtë mësimore, duke sugjeruar se një harmonizim edhe më i mirë ndërmjet procesit mësimor dhe jetës studentore do të ndihmonte në rritjen e pjesëmarrjes. Këto vërejtje lexohen më shumë si *interes dhe dëshirë për përfshirje*, sesa si pakënaqësi ndaj ofertës ekzistuese.

Në përgjithësi, përgjigjet e pyetjes së hapur përçojnë një *klimë besimi dhe vlerësimi* ndaj institucionit, ku studentët ndihen të dëgjuar dhe të përfshirë, edhe në rastet kur zgjedhin të mos shprehin komente të detajuara. Prania e disa sugjerimeve të lehta dhe të shpërndara tregon një komunitet studentor të angazhuar, që e sheh përvojën universitare si një proces në zhvillim dhe që kontribuon me refleksime konstruktive, pa e cenuar në asnjë moment vlerësimin e përgjithshëm pozitiv për UMT.

Në këtë kuptim, analiza cilësore e pyetjes së hapur *konfirmon dhe përforcon rezultatet e pjesëve të tjera të raportit*, duke e paraqitur institucionin si një mjedis akademik funksional, mbështetës dhe në zhvillim të vazhdueshëm, me hapësira të natyrshme për rafinim organizativ dhe përmirësim të përvojës studentore në vijimësi.

PËRFUNDIME

Analiza e të dhënave të mbledhura nga studentët e vitit të parë për vitin akademik 2025-2026 në UMT ofron një pasqyrë të qartë dhe të qëndrueshme mbi funksionimin e UMT-së në disa dimensione kyçe të përvojës studentore. Në tërësi, rezultatet tregojnë një vlerësim dukshëm pozitiv për elementët themelorë të ofertës akademike, organizimit institucional dhe shërbimeve mbështetëse, duke reflektuar një përputhje të mirë midis pritshmërive paraprake dhe përvojës reale të studentëve. Këto gjetje identifikojnë disa pika të forta strukturore dhe funksionale, të cilat përbëjnë baza të konsoliduara për zhvillimin e mëtejshëm të institucionit.

Pikat më të forta të institucionit (sipas fushave të vlerësimit)

1. **Përputhja mes pritshmërive dhe përvojës reale akademike:** Një nga gjetjet më të forta të analizës është niveli i lartë i përputhjes midis informacionit të ofruar përpara regjistrimit dhe përvojës reale të studentëve gjatë studimeve. Kjo tregon ndërtim të pritshmërive realiste, komunikim të besueshëm institucional dhe koherencë mes premtimit akademik dhe praktikës mësimore.
2. **Cilësia e mësimdhënies dhe përkushtimi akademik:** Cilësia e mësimdhënies vlerësohet shumë pozitivisht, duke u shfaqur si një nga shtyllat kryesore të kënaqësisë studentore. Ky rezultat nënvizon rolin e pedagogëve si faktor kyç në përvojën universitare dhe konfirmon standardet akademike si një aset i rëndësishëm i institucionit.
3. **Funksionimi i proceseve administrative bazë:** Proceset kryesore administrative, si regjistrimi në universitet dhe regjistrimi i lëndëve, perceptohen si të qarta, të thjeshta dhe funksionale. Kjo dëshmon për organizim procedural të mirë dhe për një administratë që, në përgjithësi, mbështet pa pengesa vijimin normal të studimeve.
4. **Efikasiteti i shërbimeve akademike dhe administrative mbështetëse:** Sekretaria mësimore, roli i koordinatorëve të fakultetit dhe këshillimi akademik vlerësohen pozitivisht nga shumica e studentëve. Këto struktura perceptohen si pika kontakti funksionale dhe të aksesueshme, duke kontribuar në orientimin, informimin dhe mbështetjen e studentëve përgjatë ciklit të studimeve.
5. **Infrastruktura teknologjike dhe kushtet fizike të mjedisit universitar:** Infrastruktura teknologjike, platformat digjitale dhe kushtet fizike të ambienteve universitare vlerësohen në mënyrë të qëndrueshme pozitive. Këto elemente përbëjnë një bazë të fortë për zhvillimin e aktivitetit mësimor dhe administrativ, duke krijuar një mjedis funksional dhe të përshtatshëm për studentët.
6. **Organizimi dhe funksionaliteti i orareve akademike:** Orari i leksioneve dhe seminareve perceptohet si i përshtatshëm dhe i lehtë për t'u ndjekur, çka reflekton koordinim të mirë ndërmjet strukturave akademike dhe një vëmendje ndaj nevojave praktike të studentëve.

7. **Zhvillimi i jetës jashtë kurrikulës dhe integrimi universitar:** Aktivitetet jashtë mësimore, roli i dekanatit të studentëve, klubet studentore dhe mjedisi social vlerësohen përgjithësisht pozitivisht, duke treguar se institucioni ofron hapësira reale për përfshirje, ndërveprim dhe ndërtim të komunitetit universitar. Këto elemente kontribuojnë në përvojën e përgjithshme studentore përtej procesit strikt akademik.
8. **Informimi dhe orientimi për zhvillimin profesional:** Informimi mbi mundësitë e këshillimit për karrierë perceptohet si i qartë dhe i dobishëm nga shumica e studentëve, duke reflektuar ekzistencën e mekanizmave orientues që mbështesin lidhjen mes studimeve dhe perspektivës profesionale.

Rekomandime (jo-obliguese)

Duke u mbështetur në vlerësimin përgjithësisht pozitiv të të gjitha fushave të analizuara dhe në sugjerimet e reflektuara gradualisht gjatë raportit, rekomandimet e mëposhtme paraqiten si **orientuese**, jo detyruese, dhe mund të merren në konsideratë nga njësitë përkatëse në përputhje me ekspertizën, prioritetet dhe vlerësimin e tyre profesional.


1. **Forcimi i komponentit orientues dhe informues për studentët e rinj**, përmes strukturimit më të qëndrueshëm të javës së orientimit dhe rikujtimeve të përzgjedhura gjatë fazave të para të studimeve, veçanërisht për proceset administrative dhe përdorimin e platformave digjitale.
2. **Harmonizimi i praktikave të komunikimit dhe orientimit akademik**, aty ku vlerësohet e arsyeshme, për të rritur koherencën e përvojës studentore dhe për të adresuar më mirë grupin e studentëve që pozicionohet në qëndrim neutral.
3. **Vijimi i mbështetjes për shërbimet akademike dhe administrative**, përmes ruajtjes së qartësisë procedurale dhe, nëse shihet e përshtatshme, përmes *identifikimit dhe adresimit të nevojave për formim të vazhduar të personelit*, në përputhje me instrumentet përkatëse të Paketës së Instrumenteve të Cilësisë që parashikojnë planifikimin e trajnimeve për stafin akademik dhe administrativ.
4. **Rritja e dukshmërisë së aktiviteteve jashtë kurrikulës**, përmes përdorimit më të strukturuar të formave të komunikimit të vazhdueshëm gjatë vitit akademik dhe lidhjes më të qartë të aktiviteteve me interesat akademike, sociale dhe profesionale të studentëve.
5. **Forcimi i komunikimit mbi këshillimin për karrierë**, në mënyrë të shpërndarë përgjatë ciklit të studimeve, për të rritur përvetësimin praktik të këtij shërbimi nga studentët.
6. **Ruajtja dhe monitorimi i vazhdueshëm i cilësisë së mësimdhënies**, si një nga pikat e forta të institucionit, përmes instrumenteve ekzistuese të vlerësimit institucional.

ANEKS I: Paraqitja grafike e rezultateve (Bar


Charts)

Ky aneks përmban paraqitjen grafike të të dhënave të mbledhura përmes pyetësorit, në formën e grafikëve shtyllorë (bar charts), për secilin pohim të përfshirë në analizë. Grafikët shërbejnë si material mbështetës vizual për interpretimin e rezultateve dhe janë paraqitur veçmas për të ruajtur rrjedhën analitike dhe qartësinë e raportit kryesor.


Gjinia:




Programi i studimit




Si keni dëgjuar për UMT? (Mund të zgjidhni më shumë se një alternativë):



Cili/cilët faktorë ndikuan në zgjedhjen e programit tuaj të studimeve në UMT? (Mund të zgjidhni më shumë se një alternativë)




Informacioni i ofruar nga UMT, përmes mediave dhe stafit të institucionit, përputhet me pritshmëritë e mia dhe përvojën reale që kam pasur si student në këtë universitet.




Informacioni i ofruar nga UMT, përmes mediave dhe stafit të institucionit, përputhet me pritshmëritë e mia dhe përvojën reale që kam pasur si student në këtë universitet.

Pritshmëritë e mia para regjistrimit përputhen me përvojën aktuale si student në UMT.




Pritshmëritë e mia para regjistrimit përputhen me përvojën aktuale si student në UMT.

Procesi i orientimit për studentët e rinj ishte i qartë dhe i dobishëm për të kuptuar mënyrën e funksionimit të universitetit




Procesi i orientimit për studentët e rinj ishte i qartë dhe i dobishëm për të kuptuar mënyrën e funksionimit të universitetit

Procesi i regjistrimit në UMT ishte i thjeshtë, i qartë dhe pa pengesa




Procesi i regjistrimit në UMT ishte i thjeshtë, i qartë dhe pa pengesa

Platforma online (Edu4School) e UMT për informacione akademike dhe regjistrimin e lëndëve është e lehtë për t'u përdorur dhe e dobishme




Platforma online (Edu4School) e UMT për informacione akademike dhe regjistrimin e lëndëve është e lehtë për t'u përdorur dhe e dobishme

Jam informuar qartë mbi të drejtat dhe detyrimet e mia si student në UMT




Jam informuar qartë mbi të drejtat dhe detyrimet e mia si student në UMT

Rregulloret dhe politikat e universitetit janë të qarta dhe të lehta për t'u ndjekur




Rregulloret dhe politikat e universitetit janë të qarta dhe të lehta për t'u ndjekur

Kam marrë udhëzime të mjaftueshme për përdorimin e platformave teknologjike të universitetit




Kam marrë udhëzime të mjaftueshme për përdorimin e platformave teknologjike të universitetit

Infrastruktura teknologjike e UMT, (Wi-Fi, kompjuterë, laboratorë, etj.) përmbush nevojat e studentëve




Pritshmëritë e mia para regjistrimit përputhen me përvojën aktuale si student në UMT.




Pritshmëritë e mia para regjistrimit përputhen me përvojën aktuale si student në UMT.

Pastërtia dhe mirëmbajtja e ambienteve të UMT janë në nivel të kënaqshëm




Pastërtia dhe mirëmbajtja e ambienteve të UMT janë në nivel të kënaqshëm

Cilësia e mësimdhënies në UMT përmbush pritshmëritë e mia si student




Cilësia e mësimdhënies në UMT përmbush pritshmëritë e mia si student

Sekretaria mësimore është efikase dhe e gatshme për të ndihmuar studentët




Sekretaria mësimore është efikase dhe e gatshme për të ndihmuar studentët

Koordinatori i fakultetit ofron mbështetje dhe udhëzime të dobishme për studentët




Koordinatori i fakultetit ofron mbështetje dhe udhëzime të dobishme për studentët

Këshillimi akademik është i dobishëm dhe ndihmon në planifikimin e studimeve







Këshillimi akademik është i dobishëm dhe ndihmon në planifikimin e studimeve

Procesi i regjistrimit të lëndëve është i qartë dhe i lehtë për t'u ndjekur



Procesi i regjistrimit të lëndëve është i qartë dhe i lehtë për t'u ndjekur







ANEKS I: Formulari i pyetësorit për vlerësimin e përvojës së studentëve të vitit të parë në UMT

PYETËSOR PËR VLERËSIMIN E PËRVOJËS SË STUDENTËVE TË VITIT TË PARË NË UMT

I nderuar student,

Në kuadër të sigurimit të cilësisë, *Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë* (NJSBC) në Universitetin Metropolitan Tirana (UMT) po realizon këtë pyetësor për të vlerësuar përvojën tuaj si student i vitit të parë. Pyetësori synon të mbledhë opinione mbi procesin e regjistrimit, pritshmëritë dhe eksperiencën tuaj gjatë periudhës së parë të studimeve në UMT. Të dhënat tuaja do të jenë anonime dhe do të përdoren vetëm për qëllime përmirësimi institucional. Ju falënderojmë për kohën dhe kontributin tuaj!

I. TË DHËNA DEMOGRAFIKE

1. **Gjinia:**

Mashkull
Femër

2. **Programi i studimit:** (Ju lutemi, zgjidhni një opsion nga lista më poshtë.)

Lista e programeve të UMT

3. **Qyteti nga vini:**

Përgjigje e hapur

4. **Shkolla e mesme që keni mbaruar:**

Përgjigje e hapur

II. PRITSHMËRITË DHE EKSPERIENCAT E PARA

1. **Si keni dëgjuar për UMT? (Mund të zgjidhni më shumë se një alternativë):**

- Nga studentët aktualë të UMT
- Nga prindërit ose të afërmit
- Nga pedagogët e UMT
- Nga mësuesit e shkollës së mesme
- Nga shokët/shoqet
- Nga mediat (TV, website, Instagram, Facebook, etj.)
- Nga panairë ose prezantime të organizuara nga UMT
- Tjetër (ju lutemi specifikoni): _____

2. **Cili/cilët faktorë ndikuan në zgjedhjen e programit tuaj të studimeve në UMT? (Mund të zgjidhni më shumë se një alternativë)**

- Emërtimi dhe cilësia akademike e programit të studimeve
- Tarifat konkurruese të studimeve
- Reputacioni pozitiv i UMT në tregun akademik
- Eksperienca dhe përkushtimi i pedagogëve të UMT
- Rekomandimet nga prindërit ose të afërmit
- Afërsia e universitetit me vendin e banimit tim
- Rekomandimet nga miqtë ose ish-studentët e UMT

- Fushatat promovuese të UMT në media (TV, internet, rrjete sociale, etj.)
- Tjetër (ju lutemi specifikoni): _____

3. Informacioni i ofruar nga UMT, përmes mediave dhe stafit të institucionit, përputhet me pritshmëritë e mia dhe përvojën reale që kam pasur si student në këtë universitet.

Ju lutemi, vlerësoni shkallën tuaj të dakordësisë me këtë pohim duke përdorur shkallën më poshtë:

- 1 – Plotësisht kundër
- 2 - Kundër
- 3 - Neutral
- 4 - Dakord
- 5 - Plotësisht dakord

4. Pritshmëritë e mia para regjistrimit përputhen me përvojën aktuale si student në UMT.

Ju lutemi, vlerësoni shkallën tuaj të dakordësisë me këtë pohim duke përdorur shkallën më poshtë:

- 1 – Plotësisht kundër
- 2 - Kundër
- 3 - Neutral
- 4 - Dakord
- 5 - Plotësisht dakord

III. VLERËSIMI I INFRASTRUKTURËS DHE SHËRBIMEVE

Për secilën prej pohimeve më poshtë, vlerësoni nga 1 në 5 ku:

1 – Plotësisht kundër, 2 - Kundër, 3 - Neutral, 4 - Dakord, 5 - Plotësisht dakord.

Nr.	Pohimi	Vlerësimi				
		1	2	3	4	5
1	Procesi i orientimit për studentët e rinj ishte i qartë dhe i dobishëm për të kuptuar mënyrën e funksionimit të universitetit	1	2	3	4	5
2	Procesi i regjistrimit në UMT ishte i thjeshtë, i qartë dhe pa pengesa	1	2	3	4	5
3	Platforma online (Edu4School) e UMT për informacione akademike dhe regjistrimin e lëndëve është e lehtë për t'u përdorur dhe e dobishme	1	2	3	4	5
4	Jam informuar qartë mbi të drejtat dhe detyrimet e mia si student në UMT	1	2	3	4	5
5	Rregulloret dhe politikat e universitetit janë të qarta dhe të lehta për t'u ndjekur	1	2	3	4	5
6	Kam marrë udhëzime të mjaftueshme për përdorimin e platformave teknologjike të universitetit	1	2	3	4	5
7	Infrastruktura teknologjike e UMT, (Wi-Fi, kompjuterë, laboratorë, etj.) përmbush nevojat e studentëve	1	2	3	4	5
8	Orari i leksioneve dhe seminareve është i përshtatshëm dhe i lehtë për t'u ndjekur	1	2	3	4	5

9	Pastërtia dhe mirëmbajtja e ambienteve të UMT janë në nivel të kënaqshëm	1	2	3	4	5
10	Cilësia e mësimdhënies në UMT përmbush pritshmëritë e mia si student	1	2	3	4	5
Shërbimet akademike dhe administrative						
11	Sekretaria mësimore është efikase dhe e gatshme për të ndihmuar studentët	1	2	3	4	5
12	Koordinatori i fakultetit ofron mbështetje dhe udhëzime të dobishme për studentët	1	2	3	4	5
13	Këshillimi akademik është i dobishëm dhe ndihmon në planifikimin e studimeve	1	2	3	4	5
14	Procesi i regjistrimit të lëndëve është i qartë dhe i lehtë për t'u ndjekur	1	2	3	4	5
Njohja me mundësitë jashtë kurrikulës						
15	Jam informuar rreth klubeve studentore dhe aktiviteteve jashtë mësimore që ofron UMT	1	2	3	4	5
16	Aktivitetet e organizuara nga dekanati i studentëve janë tërheqëse dhe të dobishme për integrimin universitar	1	2	3	4	5
17	Kam marrë informacion të qartë për mundësitë e këshillimit për karrierë në UMT	1	2	3	4	5
18	Mjedisi social në UMT më inkurajon të ndërtoj marrëdhënie dhe të përfshihem në aktivitete jashtë mësimore					

IV. KOMENTE SHITESË

A keni ndonjë koment apo sugjerim për të përmirësuar përvojën tuaj në UMT?

Plotëso: